



A.nr.206/2026

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës mw numër A.nr.206/2026, të datës 25.02.2026, të parashtruar nga ankuesi F.M, nga Deçani, kundër organit të punësimit/Ministritsë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, më objekt kontesti “*vlerësimi i rezultateve në punë*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1 nën, paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafin 3 dhe nenin 18, paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 dhe 1.6, të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 07.08.2026, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet pjesërisht si e bazuar ankesa me numër A.nr.206/2026, e datës 25.02.2026, e parashtruar nga ankuesi F.M, në të mënyrë që aprovohet pretendimi lidhur me kompetencën e vlerësuesit, ndërsa, refuzohen si të pabazuara pretendimet tjera si në ankesë.

II. Shfuqizohet Formulari i vlerësimit të rezultateve në punë për ankuesin i datës 10.02.2026 dhe çështja kthehet në rivlerësim të organi i njëjtë, me detyrimin që në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi të bëjë rivlerësimin e rezultateve në punë për ankuesin.

III. Obligohet Sekretarja e Përgjithshme të Ministritsë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural që në afat prej 15 ditësh nga dita e zbatimit të pikës II të këtij vendimi, të eliminojë shkeljet e konstatuar si në arsyetimin e këtij vendimi, në atë mënyrë që caktimi i ushtruesit të përkohshëm të detyrës së Drejtorit të Institutit Bujqësor të Kosovës, të bëhet në pajtim të plotë me dispozitat e nenit 35 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, i plotësuar dhe ndryshuar me nenin 9 të Ligjit Nr.08/294.

VI. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të njoftohet me shkrim për veprimet e ndërmarra në kuptim të zbatimit të këtij vendimi.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil, F.M (tutje referuar vetëm ankuesja), më datë 25.02.2026, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Formularit për vlerësimin e rezultateve në punë të datës 10.02.2026.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*tutje Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Podujevës, ndërsa, kjo e fundit, ka përcjell përgjigjen në ankesë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për shqyrtimin e kësaj lënde ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 994/2026 të datës 25.02.2026, e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës; Kopjen e ID-së së ankuesit; Detyrat e Zyrtarit të Lartë për Pemëtari, Formularin për vlerësimin e rezultateve në punës i datës 10.02.2026; Akt Emërimit e datës 01.04.2016 të ankuesit; Vendimin A.nr.1196/2025 të KPMSHCK-së; Njoftimin e datës 04.12.202 për anulimin e konkursit për pozitën Drejtor i Institutit Bujqësor; Emailin e datës 11.07.2025 nga ankuesi për V.Ç dhe E.K; Emailin e datës 11.07.2025 të F.M për ankuesin; Emailin e datës 14.07.2025 nga A.O për B.B etj; Emailin e datës 14.07.2025 nga ankuesi për A.O; Emailin e datës 22.07.2025 nga ankuesi për A.O etj; Emailin e datës 24.07.2025 nga ankuesi për V.Ç; Emailin e datës 22.08.2025 nga E.K për A.O; Emailin e datës 22.08.2025 nga A.O për E.K; Shkresë për reagim zyrtar datës 22.08.2025 nga ankuesi për E.K; Ftesë për takim datës 25.08.2025 nga A.O për E.K; Emailin e datës 31.07.2025 nga A.O për E.K; Shkresë për takim me përfaqësuesen e të drejtave të njeriut dhe Menaxheren e Personelit datës 04.09.2025; Shkresë për takim e datës 10.09.2025 nga ankuesi për Koordinatorin e NJMDNJ; Vendimin Ref.ZSP-1091/23 të datës 03.11.2023 për caktimin e ushtruesit të detyrës së Drejtorit të Institutit Bujqësor të Kosovës; Vendimin Ref.ZSP-468/53 të datës 17.07.2025 për caktimin e ushtruesit të detyrës së Drejtorit të Institutit Bujqësor të Kosovës; Vendimin Ref. ZSP-396/25 të datës 25.06.2025 për formimin e komisionit të pranit për furnizim dhe montim me kamera sigurie për Institutin e Pylltarisë-Pejë; Vendimin Ref.ZSP-757/24 të datës 14.11.2024 për formimin e grupit punës për hartimin e projekt programit për skemat e pagesave direkte për hortikulturës për vitin 2026; Emailin e datës 24.06.2025 nga XH.M për SH.Z etj; Emailin e datës 24.06.2025 nga A.O për XH.M; Vendimin Ref.ZSP.755/25 të datës 13.11.2025 për emërimin e menaxherit të kontratës; Shkresë me titull Komisioni i përpilimit të specifikave për furnizim e fermës me mekanizëm dhe pajisje bujqësore datës 16.09.2025; Vendimin Ref.ZSP:79/2025 të datës 24.02.2025; Plani vjetor i punës i vitit 2025; Plani për operacionet e punës gjatë ekzekutimit teknik 2025; Plani vjetor për aktivitete në pemëtari nga ankuesi 2025; Shkresë me titull Njoftim rreth kaplimit të zjarreve në pronën tonë në Arbneshë datës 04.08.2025; Raportin e komisionit të vlerësimi të dëmeve në përmishten amë datës 27.08.2025; Dokumenti i shërbimeve agroteknike 2025; Formular: Skema për identifikimin e varieteteve Dardha; Akt Emërimi i datës 28.04.2014 për B.B; Pagesa për periudhën janar 2026 për B.B; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 02.03.2026; Përgjigjen në ankesë e datës 13.03.2026; Akt emërimit e datës 01.04.2016 të ankuesit; Emailin e datës 30.09.2024 nga Drejtori i DMZP-SË; Ndryshimi dhe plotësim i aktit të emërimit datës 09.02.2017 për A.O; Akt Emërimit e datës 01.01.2014 për V.Z; Raporti javor i punës së Institutit Bujqësor të Kosovës i datës 07.11.2025, 14.11.2025, 21.11.2025, 27.11.2025, 05.12.2025, 12.12.2025, 26.12.2025, 31.12.2025, 16.01.2026.

Kolegji i Këshillit pasi shqyrtimit dhe analizimit të provave materiale veç e veç dhe të gjitha së bashku në tërësinë e tyre, ka gjetur se ankesa është pjesërisht e bazuar, sepse:

I. Vlerësimi i gjendjes së fakteve

Nga provat e administruara rrjedhë se:

- Ankuesi sipas Akt Emërimit më numër protokolli 1350, të datës 01.04.2016, mbanë pozitën e punës *Zyrtar i Lartë për Pemëtari* në Institutin Bujqësor të Kosovës në Pejë, në kuadër të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.
- Ushtruesi i detyrës së Drejtorit të Institutit Bujqësor të Kosovës, në cilësi të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të ankuesit më datë 10.02.2026, ka bërë vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesin për vitin 2025 dhe të njëjtin e ka vlerësuar më nivel të përgjithshëm të vlerësimit “*Ka nevojë për përmirësim*”.

II. Pretendimet ankimore

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundërshton vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2025, të realizuar sipas formularit të datës 21.02.2026, duke pretenduar se vlerësimi është bërë nga një person që është caktuar ushtrues detyrës i Drejtorit të Institutit Bujqësor të Kosovës, në kundërshtim me nenin 35 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, pra ka tejkalim të afatit të caktimit të ushtruesit të detyrës dhe po ashtu caktimi i ushtruesit të detyrës nuk është nga kategoria pasuese, sepse, në kuadër të Institutit Bujqësor, ekzistojnë dy pozita të kategorisë së ulët drejtuese ndërsa ushtruesi i detyrës vjen nga një pozitë e kategorisë profesionale, pra në kundërshtim me legjislacionin në fuqi. Shton se vlerësimi i rezultateve në punë nuk është real, ngase për gjatë periudhës asnjëherë nuk kam qenë i njoftuar për ndonjë ngecje në punë dhe nuk kam marr asnjë vërejtje për punën e bërë, dhe kam kryer të gjitha detyrat e mia. Kërkon që të trajtohet paligjshmëria e caktimit të ushtruesit të detyrës së Drejtorit të Instituti Bujqësor të Kosovës. Të anulohet vlerësimi i rezultateve në punë, dhe të bëhet një rivlerësim nga një komisioni i ngritur nga ana e MBPZHR i pa anshëm.

III. Vlerësimi i Kolegjit

Kolegji i Këshillit lidhur me pranueshmerinë e ankesës konstaton se e njëjta është e lejueshme në kuptim të nenit 52, paragrafi 17 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, dhe e njëjta është e pranueshme në kuptim të nenit 127 paragrafi 1 ndërlidhur me nenin 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Ndërsa, në kontekst të shqyrtimit të pretendimeve ankimore Kolegji i Këshillit iu referua nenit 52 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, më të cilin është përcaktuar se: *1. Vlerësimi i rezultateve në punë është proces i vazhdueshëm, që përfshin vlerësimin e realizimit të objektivave të paracaktuara, vlerësimin e aftësisë profesionale, metodologjike, personale dhe sociale të nëpunës/it civil në realizimin e objektivave dhe përmbushjen e përgjithshme të përgjegjësisë të njësisë. 2. Periudha e vlerësimit zgjat një (1) vit, nga 1 janari deri me 31 dhjetor. Procedura e dhënies së vlerësimit përfundon deri më 28 shkurt të vitit pasues. 3. Vlerësimi i rezultateve në punë bazohet në: 3.1. realizimin e objektivave të paracaktuara në planin vjetor individual, përmbushjen e detyrave të punës në përputhje me përshkrimin përkatës të punës, objektivat e njësisë dhe institucionit, si dhe kryerjen e detyrave të atypëratyshme që nuk janë paracaktuar paraprakisht apo nuk kanë mundur të paracaktohen; 3.2. aftësitë profesionale të shfaqura nga shërbyesja/i civil gjatë ushtrimit të*

detyrës, si dhe sjelljen profesionale; 3.3. aftësitë metodologjike, personale dhe sociale të shfaqura nga shërbyesja/i civil gjatë ushtrimit të detyrës. 4. Përcaktimi i objektivave individuale të nëpunëses/it civil bëhet nga mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë në bashkëpunim me nëpunësen/in dhe përfaqësuesen/in e njësisë së burimeve njerëzore, me shkrim, në muajin janar të çdo viti, së bashku me planin individual të punës për arritjen e këtyre objektivave. 5. Plani individual i punës i përcaktuar në paragrafin 4. të këtij neni, mund të rishikohet nga mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë dhe përfaqësuesja/i i njësisë së burimeve njerëzore, në bashkëpunim me nëpunësen/in civil. 6. Procedura e vlerësimit të rezultateve në punë përfshin dy (2) faza kryesore: 6.1. mbikëqyrjen e vazhdueshme të rezultateve të punës nga mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë; 6.2. vlerësimin vjetor të rezultateve të punës nga mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë dhe përfaqësuesja/i i njësisë së burimeve njerëzore. 7. Performanca e nëpunëses/it civil të kategorisë profesionale dhe kategorisë së specialistes/it vlerësohet nga mbikëqyrësja/ie saj/tij i drejtpërdrejtë dhe përfaqësuesja/i i njësisë së burimeve njerëzore. 8. Performanca e nëpunëses/it civil të kategorisë së ulët, të mesme dhe të lartë drejtuese, vlerësohet nga mbikëqyrësja/i i saj/tij i drejtpërdrejtë, udhëheqësja/i më i lartë administrativ dhe nga nëpunësitqë ka në vartësi. 9. Përfundimisht, në rastin e ndërrimit të mbikëqyrëses/it përpara përfundimit të vlerësimit vjetor, secila/i mbikëqyrëse/ës vlerëson nëpunësen/in vetëm për periudhën përkatëse. 10. Përfaqësuesja/i i njësisë së burimeve njerëzore, merr pjesë, mbështet dhe vëzhgon çdo proces të vlerësimit. 11. Mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë gjatë procesit të vlerësimit është e/i obliguar të vlerësojë nëpunësen/in në mënyrë objektive dhe të argumentojë vlerësimin. 12. Në fund të periudhës së vlerësimit, mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë dhe përfaqësuesja/i i njësisë së burimeve njerëzore zhvillojnë takim me nëpunësen/in për vlerësimin e rezultateve të punës. Pas takimit, mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë aprovon formularin e vlerësimit që e nënshkruajnë të gjitha palët. 13. Nivelet e vlerësimit të rezultateve në punë janë: 13.1. arritje e jashtëzakonshme; 13.2. tejkalon pritshmëritë; 13.3. arrin pritshmëritë; 13.4. ka nevojë për përmirësim; 13.5. e papranueshme. 14. Në rastin e vlerësimit në nivelet sipas paragrafit 13, nën-paragrafëve 13.4. dhe 13.5. të këtij neni, për përmirësimin e aftësive profesionale, mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë, në bashkëpunim me NjMBNj-në e institucionit, miraton trajnimet e detyrueshme, që nëpunësja/i duhet t'i ndjekë vitin që vjen dhe sipas vlerësimit mund të ofrojë edhe rekomandime për transferimin me qëllim të përmirësimit të rezultateve të punës. 15. Në rastin e vlerësimit në nivelet sipas paragrafit 13, nën-paragrafit 13.4. dhe 13.5. përpos trajnimeve të detyrueshme, mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë në bashkëpunim me NjMBNj-në e institucionit, vendos që nëpunësja/i civil i nënshtrohet një vlerësimi të veçantë. 16. Periudha e vlerësimit të veçantë sipas paragrafit 15. të këtij neni, është sa një e katërta (1/4) e periudhës së vlerësimit vjetor të përcaktuar sipas paragrafit 2. të këtij neni. 17. Nëpunësja/i civil e cila nuk është e kënaqur me vlerësimin si në paragrafin 13. nën-paragrafit 13.4. dhe 13.5. të këtij neni, ka të drejtë të paraqesë ankesë në KPMSHCK, sipas afatit të përcaktuar në ligjin përkatës për procedurën administrative...

Në kuptim të pretendimit ankimor së vlerësimi i kontestuar i rezultateve në punë është bërë nga ushtruesi i detyrës së Drejtorit të Institutit Bujqësor të Kosovës në Pejë, i emëruar në kundërshtim me ligjin material, kolegji iu referua bazës ligjore në fuqi që rregullon çështjen e ushtruesit të detyrës gjegjësisht nenit 35 të Ligji Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, më të cilin përcaktohet se: 1. Në rast se një pozitë e nivelit drejtues brenda strukturës organizative të institucionit mbetet e lirë, nëpunësja/i i nivelit të lartë drejtues e atij institucioni e cakton me vendim ushtruesen/in e detyrës për pozitën e lirë. 2. Në pajtim me paragrafin 1. të këtij neni, ushtruesja/i i detyrës mund të caktohet zyrtarja/imë i lartë i kategorisë pasuese, në vartësi të

pozitës që caktohet, nga cilado njësi organizative brenda institucionit..” si dhe nenin 9 të Ligjit Nr. 08/L-294 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, ku përcaktohet: 1. Paragrafi 1. i nenit 35 të ligjit bazik ndryshohet si në vijim: 1. Në rast se një pozitë e nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues brenda strukturës organizative të institucionit mbetet e lirë, nëpunësi i nivelit të lartë drejtues i atij institucioni e cakton me vendim ushtruesin e detyrës për pozitën e lirë. Për kategorinë e nivelit të lartë drejtues, ushtruesin e detyrës e cakton titullari...dhe si rrjedhojë duke u bazuar në këtë kuadër ligjor, si dhe duke u bazuar në provat materiale të lëndës, Kolegji ka gjetur së sipas Vendimit Ref. ZSP:109/23 Nr.926, të datës 03.11.2023 të Sekretares së Përgjithshme të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Arben Osmani, Zyrtar i Lartë për Laboratori të Kontrollit dhe Kualitet të Farërave në Institutin Bujqësor të Kosovës, është caktuar ushtrues detyre i Drejtorit të Institutit Bujqësor të Kosovës, me tej sipas Vendimit Ref. ZSP:772/24 Nr.478, të datës 13.11.2024, të Sekretares së Përgjithshme të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, A.O i vazhdohet pozita e ushtruesit të detyrës së Drejtorit të Institutit Bujqësor të Kosovës deri në një vendim tjetër, ashtu që më Vendimin Ref. ZSP:468/25 Nr.321, të datës 17.07.2025 të Sekretares së Përgjithshme të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, zyrtari A.O, serish caktohet ushtrues detyre i Drejtorit të Institutit Bujqësor të Kosovës. Pra, në kuptim të këtij përcaktimi ligjor rezulton së në rastin e emërimit të ushtruesit të detyrës së Drejtorit të Institutit Bujqësor të Kosovës, nuk është respektuar kriteri i kategorisë pasuese, sepse, nëpunësi civil A.O, mbanë pozitën Zyrtar i Lartë për Laboratori të Kontrollit dhe Kualitetit të Farërave në Institutin Bujqësor të Kosovës, si pozitë e kategorisë profesionale, sipas nenit 38 paragrafi 2 nën paragrafi 2.5 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, ndërlidhur me nenin 4 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Rregullores (QRK) Nr. 06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil. Ndërsa, bazuar në shkresat e lëndës vërtetohet së në kuadër të Institutit Bujqësor të Kosovës janë dy pozita të kategorisë së ulët drejtuese: Udhëheqës i Fermës Hulumtuese dhe Udhëheqës për Trajnim dhe Informim në Institutin Bujqësor të Kosovës.

Ndërlidhur me pretendimin për vlerësim jo të drejtë të ankuesit, Kolegji nga analizimi i provave të deponuara nga ankuesi ka vërtetuar së i njëjti ka ofruar si dëshmi vetëm planin objektiv të punës për vitin 2025 i nënshkruar nga ankuesi dhe mbikëqyrësi si dhe Planin për Operacionet e Punës gjatë ekzekutimit teknik 2025, mirëpo, ankuesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi lidhur me përmbushjen e detyrave të punës, rrjedhimisht, ankuesi nuk prezanton raporte javore (apo mbi baza tjera kohore) lidhur me aktivitetet e realizuar në kuptim të përmbushjes së detyrave të punës. Kurse, në anën tjetër, pala tjetër gjegjësisht institucioni me rastin e përgjigjes në ankesë ka deponuar vetëm raportet e përgjithshme të punës për Institutin Bujqësor të Kosovës nga data 31.10.2025 deri 31.12.2025, e sipas të cilave raporte lidhur me sektorin e pemëtarisë janë vendosur aktivitete me përshkrim të njëjtë pa aktivitete konkrete dhe të matshme. Për me tepër, nga shkesat e lëndës Kolegji nuk vëren prova nëse ankuesit i është tërheq vërejtja për mos përmbushje të detyrave të punës, realizim jo të kënaqshëm të detyrave të punës apo edhe mos raportim të punës.

Andaj, nisur nga konstatimi përkitazi me ushtruesin e detyrës së Drejtorit të Institutit Bujqësor të Kosovës e Përkitazi, në cilësi të vlerësuesit, Kolegji thekson faktin së ankuesi në bashkëpunim me mbikëqyrësin e tij në këtë rast Arben Osmani me datës 30.01.2025, kanë nënshkruar pa vërejtje Planin Objektiv të punës për ankuesin për vitin 2025, dhe se ankuesi as në këtë rast e po ashtu me asnjë veprim tjetër nuk ka kontestuar emërimin e ushtruesit të detyrës së Drejtorit të Institutit Bujqësor të Kosovës, andaj, duke qenë së vet akti i

emërimin të detyrës së Drejtorit të Institutit Bujqësor të Kosovës nuk cenon të drejtat e ankuesit, Kolegji nisur nga mandati kushtetues i KPMSHCK-se në garantim të respektimit të parimeve dhe rregullave të shërbimit civil, ka vendosur si në pikën II të dispozitivit, në atë mënyrë që institucionet publike që kanë të punësuar nëpunës civil duhet të veprojnë në përputhje me Kushtetutën, legjislacionin në fuqi, si edhe me rregullat e përgjithshme administrative të zbatueshme brenda kompetencave të tyre dhe në përputhje me qëllimin për të cilat janë dhënë këto kompetenca (neni 4 i LPPA-së).

Rrjedhimisht, duke qenë së aktet lidhur me caktimin e ushtruesit të detyrës së Drejtorit të Institutit Bujqësor të Kosovës kanë qenë në fuqi dhe nuk është kontestuar ligjshmëria e tyre, atëherë, këto akte kanë prodhuar pasoja juridike, duke përfshirë edhe faktin e vlerësimit të ankuesit për vitin 2025, andaj, edhe Kolegji vendosi si në pikën II të dispozitivit.

Kolegji mbi gjendjen e fakteve dhe rrethanave si më lartë, nuk mund të vendosë meritorisht lidhur me pretendimin ankimor referuar vlerësimit për periudhën janar-qershor 2025, kështu që, vendosi që çështja të kthehet në rishqyrtim dhe rivlerësimin me obligimin që mbikëqyrësi i ankuesit të bëjë rivlerësimin e rezultateve në punë për ankuesin për periudhën janar-qershor 2025, ashtu që vlerësimi të jetë i qartë dhe argumentues me prova konkret materiale, si dhe në rivlerësim ankuesit ti ofrohet mundësia e diskutimit lidhur me vlerësimin si dhe ofrimit të kundër argumenteve.

Kolegji nga shqyrtimi dhe analizimi i prova materiale të parashtruara nga palët në procedurë nuk ka arritur të vërtetojë nëse mbikëqyrësja e ankuesit ka ndërmarr ndonjë veprim në kuptim të mbikëqyrjes e vazhdueshme të rezultateve të punës të ankuesit dhe po ashtu nuk ka prova nëse është zhvilluar ndonjë takim në fund të periudhës vlerësuese në mes të ankuesit dhe mbikëqyrëses për të diskutuar rreth vlerësimit, veprime procedurale të parapara më paragrafin 6.1 dhe paragrafin 12 të nenit 52 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë.

Këshillë juridike:

Ky vendim hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Administrative në Prishtinë- Departamenti për Konteste të Punës, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

A.nr.206/2026

Avdyl BEKTESHI

Ardita Haxhnikaj-DEMI

Procesmbajtës

Kryetare Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit F.M;
- Organit të punësimit: Sekretares së Përgjithshme dhe Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në MBPZHR dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.